



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Durrës më, __. __. 2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SHËRBIMET E PËRMIRËSIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË SOFTWARE-VE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

SHËRBIMET E LIDHURA ME SOFTWARE-VE (72260000-5)

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,965,000 (Trembëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH

Fondi Limit

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit i jemi referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021 të ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës** sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Formularit përmbledhës të vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiar **2021, 2022 dhe 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar ne nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të

2

tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022 dhe 2023** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

- a) Të paktën 2 (dy) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në sistemin aktual ose te teknologjive që perdoren në këtë sistem.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher për zbatime/implementime të sistemeve ERP.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional në konceptet, inxhinierizimin e Web shërbimeve dhe protokollit SOAP ose ekuivalent .
- d) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionist.
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat e shkollës së lartë
2. Certifikatat/transcriptet që vertetojnë certifikimet e mesiperme të kerkuara
3. Formularët E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së zhvillimit të procedurës

Shënim: Një punonjës mund të disponojë edhe më shumë se një certificate.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktuese përcaktojnë kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë duke u bazuar në:

- a) Pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,
- b) Gjendjen ekonomike dhe financiare,
- c) Aftësinë teknike dhe profesionale."

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilin nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar janë kryer në baze të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termit e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjithë informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të afroje trajnim për përdoruesit.

a) Punonjësit i kërkuar në pikën "a" garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që kanë OE. Disponimi i tyre garanton implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjatë gjithë afatit dhe fazave të kontratës, garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK. Gjithashtu këta specialistë garantojnë vijueshmëri normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Sistemi objekt kontrate sic është shpjeguar në specifikimet teknike ka nevojë për UPGRADE dhe në mënyrë të tillë që të realizohet me sukses e gjithë procedura dhe brenda afatit të parashikuar është i nevojshëm disponimi i punonjësve me certifikimet e mesiperme.

b) Punonjësi i kërkuar në pikën "b" vjen si nevojë pasi Implementimi i sistemeve ERP, kërkon njohuri specifike për të cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve ERP por edhe me njohjen e praktikave kontabel dhe operacionale të ndërmarrjeve sidomos në rastin e shoqërive të mëdha dhe komplekse sic është SHRUK Durrës. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për upgrade dhe mirëmbajtjen e sistemeve nga të cilat përbehet FLARE ERP. Disponimi i punonjësve me një certifikim të tillë i ofron garanci AK për zbatimin me përpikëri të kontratës dhe arritjen e rezultateve konkrete.

c) Punonjësi i kërkuar në pikën "c" nevojitet për të garantuar integrimin mes sistemeve të brendshme dhe me sistemet e paleve të treta. Këto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara. Në këtë mënyrë garantohet integrimi mes sistemeve të brendshme, me institucionet financiare bankë dhe jo bankë të cilat kanë sistemi aktual për të rakorduar automatikisht detyrimet

dhe pagesat lidhur me abonentet, integrimi keto qe perdorin protokolle standarte Soap, Rest ose ekuivalente sic eshte cituar dhe ne specifikimet teknike.

d) Punonjësi i kërkuar në pikën ”d” garanton AK qe operatori ekonomik ka ne perberje te tij stafin me aftesi profesionale ne menyre qe i gjithë projekti te realizohet konform te gjitha kerkesave dhe afateve te percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike. Punonjesi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerezve dhe burimeve te OE per te patur zbatim te suksesshem te projektit sipas standarteve dhe praktikave me te mira nderkombetare duke marre ne konsiderate rendesine dhe kompleksitetin e projektit. Nje menaxher projekti eshte pergjegjes per ndjekjen e te gjithë ciklit te nje projekti qe prej analizes dhe dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve te programit.

e) Punonjësi i kërkuar në pikën ”e” lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kerkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes). Nje certifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kjo kerkese I deshmon autoritetit kontraktor qe operatori ekonomik(nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin, konceptimin e sherbimeve IT te projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithë ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes qe jane shume te rendesishme per AK dhe te vena ne dukje ne DST dhe specifikime teknike.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponoj Certifikatat për standardet e mëposhtëme, të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me objektin e prokurimit të kesaj procedure:

- Certifikatën ISO 9001:2015 standardi i menaxhimit te cilesise (ose ekuivalente e perditësuar)
- Certifikatën 27001:2017 standardi i sigurise se informacionit
- ISO 20000 (manaxhimi i sherbimeve IT) e cila duhet te perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe te sherbimeve qe prokurohen.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 77 dhe 79 të LPP, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur

ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit:

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo çertifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve software dhe kryerjen e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni te jete ne gjuhen shqipe si dhe te kete te gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresen web te prodhuesit apo Distributorit per konfirmim te dokumentave te

paraqitura. Te jete e percaktuar emri, nipt dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi te kete edhe daten e leshimit perpara dates se zhvillimit te tenderit.

***Argumentimi:** Me ane te ketij kriteri autoriteti kontraktor kerkon te forcoje besimin qe operatori ekonomik i interesuar do te ofroje UpGrade, te dorezimit te licensave te reja aty ku ka te tilla dhe sherbime te tjera te sistemit, brenda afateve, te garantuar dhe te sigurt sipas standarteve te rekomanduara nga AKCESK dhe AKSHI duke pasur mbeshtetjen e Prodhuesit apo Distributorit te Produkteve Software objekt te kesaj kontrate. Gjithashtu autoriteti nepermjet ketij autorizimi garanton qe te gjitha te dhenat historike jane te sigurta gjate ketij procesi i cili eshte shume kritik dhe garanton rikthimin e tyre ne gjendje fillestare ne rast te cdo anomalie gjate UpGradi-imit.*

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. KËRKESAT FUNKSIONALE

Sherbim dhe mirembajtje e softwareve per SHRUKD ku kerkohet Up Grade dhe Mirembajtja e FLARE ERP per sistemet qe menaxhojne te dhenat e shoqerise, FLARE Accounting, FLARE Billing, FLARE HR & Payroll, Mobiread dhe portali i Kujdesit per Klientin per 12 muaj nga dita e neserme e punes pas nenshkrimit te kontrates. Nisur nga rekomandimet e AKSHI-t dhe ACESK-ut, dy institucione qe monitorojne sigurin e sistemeve, kerkohet te Up – Gradohen sistemet dhe te mirmbahen sistemet qe shoqeria ka ne perdorim. Up – Grade duhet te perfshije kalimin ne teknologji bashkohore, automatizimin e kontrolleve te mbylljes se periudhave te faturimit, etj. Mirembajtja duhet te perfshije garantimin e sherbimit te sistemit pa nderprerje, sistemin e problemeve ne funksionalitete, perditesimi sipas ndyshimeve ne legjislacion, auditin per sigurin e sistemit etj. Kompania e cila do te beje mirembajtjen e sistemit duhet te ofroje support sipas parashikimit ne kontrate me maksimumin 2 ore kohe pergjigje me mail dhe ne raste emergjente kur problem nuk mund te zgjidhet ne distance me 4 ore kohe pergjigje ne vend

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

2. HYRJE

FLARE ERP e perbere nga FLARE Accounting, FLARE Billing, FLARE HR & Payroll dhe MOBIREAD përdoret nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës. Sistemi është në përdorim prej vitit 2012. Si cdo sistem informatik enteprese, FLARE ERP ka nevojë për upgrade dhe mirëmbajtje profesionale nga kompani të specializuara.

Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është upgrade i sistemit dhe mbajtja në kushte optimale të punës së sistemit

.

3. REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Up Grade i sistemit dhe dorezimi i licensave të përditësuara të përdorimit aty ku nevojitet.
- Mirëmbajtja e sistemit ku përfshihen mbështetja e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime apo rregullime të ndryshme dhe zhvillimet e ndryshimet në sistem sipas ndryshimeve të legjislativës në lidhje me funksionet e sistemit si kontabilitet, llogaritje pagash, burime njerezore, etj.

4. SUPOZIMET DHE RISQET

Faktori kyç i finalizimit me sukses të këtij projekti analizimi i kujdesshëm i proceseve ekzistuese të punës dhe sistemeve aktuale. Bashkëpunimi me stafin e departamentit të IT-së së Shoqërisë Rajonale do të lehtësojë mbledhjen e informacioneve të duhura rreth sistemeve ekzistuese.

a. Supozimet e Projektit

Faktori kyç i finalizimit me sukses të këtij projekti është analiza e kujdesshme e proceseve egzistuese të punës, sistemit aktual dhe kryerja e testeve të ngarkesës. Zbatimi i teknikave të optimizimit të transmetimit të të dhënave, procesimit paralel dhe parimeve të sigurisë së informacionit mbeten kritike për arritjen e objektivave të projektit.

b. Risqet

- Mos analizimi i mirë i proceseve aktuale të punës
- Keq interpretimi i faktoreve që ndikojnë në performancë e sistemit
- Humbja e informacionit sipasojë e modifikimeve në sistemin egzistues
- Vonesa në procesin e “deploy” të zhvillimeve

5. KËRKESAT FUNKSIONALE

Upgrad-I dhe Mirembajtja e sistemit FLARE ERP për modulet FLARE Accounting, FLARE Billing, FLARE HR & Payroll, Mobiread. Upgrad-i duhet të përfshijë përditesimin e teknologjisë, automatizimin e kontrolleve të ndryshme etj.

Mirembajtja duhet të përfshijë garantimin e shërbimit të sistemit sipas parashikimeve në kontratë. Ajo duhet të përfshijë ndryshimet e legjislacionit për kontabilitetin, legjislacionin e punës, faturimit, arketimit.

6. LOGJISTIKA DHE KOHA

6.1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Durrës.

6.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projektit do të jetë dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e mirembajtjes do të mbulojë 12 muaj kurse upgrade duhet të përfundojë brenda 5 ditësh pune.

7. RAPORTIMI

7.1. Kërkesat për Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportin e aktiviteteve të mirembajtjes mujore tek ndjekësit e kontratës të miratojnë raportin e mirembajtjes. Raporti duhet të jetë në gjuhën shqipe në origjinal dhe 1 kopje.

8. Up Grade

- Upgrade i PHP nga V8 në V8.2

- Upgrade i Databazas te sistemit nga MySql V8 ne MySql V8.2
- Server i reporteve Apache Tomcat duhet te upgradohet ne versionin me te fundit dhe gjithashtu libraria e integrimit me MySql te perditesohet ne versionin 8.2.
- Te upgradohet menyra e Backup-it duke realizuar nje Backup automatik ditor te enkriptuar i cili duhet te ruhet ne nje storage te jashtem per mbrojtje me te larte ne rast korruptimi te serverit aktual.
- Te upgradohet menyra e mbylljes se periudhes se faturimit nga ajo manuale ne ate automatike.
- Sistemi duhet te realizoje ne menyre automatike llogaritjen e faturave te periudhes pa nevojten e veprimeve manuale ne databaze.
- Mbyllja duhet te gjeneroje faturat ne format PDF.
- Sistemi te upgradohet me kontrollin automatik i mbylljes se periudhes.
- Para mbylljes se periudhes se faturimit sistemi duhet te ralizojte kontrolle te konsumeve si me poshte:
 - o Konsume mbi mesataren per nje % te caktuar
 - o Konsume negative
 - o Konsume te pa rregjistruara (kur eshte abonent me mates dhe del pa konsum)
- Kontrolle te integritetit te te dhenave si me poshte
 - o Lidhja e planit tarifor me kategorine e abonentit
 - o Regjistrim i nje artikulli per faturim me shume se nje here
- Per kontrollet e mesiperme, sistemi duhet te beje sistemimet automatikisht

Shenim : Up Grad-i duhet te perfundoje per nje periudhe kohore brenda 5 diteve pune nga nenshkrimi i kontrates dhe OE duhet te garantoje qe ne rast te padeshiruar te ndonje gabimi, te jete e mundur ne cdo kohe qe sistemi te kthehet ne gjendjen e meparshem duke mos humbur asnje te dhene te tij.

Teknologjite nga te cilat perbehet Flare ERP:

- Kategoria e zgjidhjes: ERP

- Modulet e perfshira: faturim dhe arketim, burime njerezore dhe llogaritje pagash, kontabilitet dhe finance, lexim i ujematesve nepermjet PDA, vete kudjesi i abonentit, raportim, integrim I ndersjellte mes te gjithe moduleve, etj.
- Pronesia intelektuale: SHRUK Durres nuk zoteron pronesine intelektuale te zgjidhjes dhe as te drejten e autorit, ato jane pronesi e prodhuesit/autorit,
- Database: MySql,
- Gjuhet e programimit: PHP, Node.js, Javascript (obviajs.com), HTML, Bootstrap, CSS, Java per Android
- Web server: Apache web server,
- Server i raporteve: Apache tomcat,
- Sistem operimi: Ubuntu Linux,
- Firewall: Iptables, ufw
- Deploy management: Jenkins
- Api dhe web sherbime: SOAP, REST, xml

9. Mirembatja

- Te mirembaje sistemin sipas SLA-s te parashikuar ne kontrate duke u pergjigjur ne kohe per cdo problem qe raportohet nga ana e stafit te shoqerise.
- Te sistemoje keqfunksionimet e sistemit qe mund te shfaqen gjate punes.
- Te mirembaje nderfaqen e funksionaliteteve per pagesat nga palet e treta e cila realizohet nepermjet protokolleve te njohura si psh SOAP, REST etj. Mirembatja te garantoje siguri per sherbimet web (SOAP/REST/XML-Rpc) bazuar ne autentifikim ne dy nivele dhe komunikim te enkriptuar per tu dhene mundesi agjenteve te jashtem te komunikojne ne menyre te sigurt.
- Te dorezoje raportet e mirembatjes sipas afateve te vendosura ne planin e punes.
- Te perditesoje modulet me ndryshimet e legjislacionit, (sic jane ndryshimet e pages minimale, ndryshime ne kodin e punes, ndryshime ne paketat fiskale etj)

Shenim : Mirembajtja do te jete per nje periudhe kohore 12 muaj nga data e perfundimit te UP Grad-it.

Shtojca 6

FORMULARI I SHERBIMEVE DHE GRAFIKUT TE EKZEKUTIMIT

Objekti : Sherbimet qe kerkohen qe kerkohen: “*Sherbim dhe mirembajtje e softwareve per SHRUKD*”

| Sherbimet | Pershkrimi | Vendi i ekzekutimit | Afati i ekzekutimit |
|-----------|---|---------------------|--|
| 1 | UpGrade i sistemit <i>FLARE ERP</i> dhe dorezim i licensave te updatuara aty ku nevojitet | SHRUK Durres | 5 dite pune |
| 2 | <i>Mirembajtja e sistemit FLARE ERP</i> | SHRUK Durres | 12 muaj nga data e perfundimit te Up Grade |

- Nisur nga dinamika e punes afati i Up Grad-imit do te jete 5 dite pune nga lidhja e kontrates. Periudha e mirembajtjes eshte 12 muaj dhe nis ne daten e perfundimit te Upgrade. Orari i suportit do te jete e Hene – Premte ora 8:00 – 16:00 duke perjashtuar festat zyrtare.